

1. Cili grup të dhënash ka mesoren 5 dhe modën 7.  
A)1,2,3,4,5,6,7    B)5,5,5,5,7,8,9  
C)3,4,5,5,5,5,7    D)3,4,5,5,7,7,7
2. Cili numër duhet vendosur në kutizë që mesatarja aritmetike e numrave 6,5,4,3,( ) të jëtë 6  
A)2    B)6    C)12    D)15
3. Në grupin e të dhënave -3,-2,-1,1,2,3 cila nuk është zero:  
A)mesatarja    B)moda  
C)mesorja    D)shuma e numrave
4. Në një testim një grup me 30 nxënës ka fituar mesatarisht 18 pikë. Sa do të ishte mesatarja e grupit nëse çdo nxënës do të merrte dyfishin e pikëve  
A)18    B)20    C)36    D)s'mund të gjendet
5. Grupi i I me 10 nxënës mori mesatarisht 8 pikë në një testim. Grupi i II me 20 nxënës mori mesatarisht 11 pikë në po atë testim. Sa është mesatarja e pikëve të marra nga të dy grupet?  
A)9,5    B)10    C)19    D)s' mund të gjendet
6. Sa numra dyshifrorë formohen me numrat 1,3,5,7,9 po qe se lejohet përsëritja e shifrave.  
A) $5^5$     B)5!    C) $5^2$     D)20
7. Sa numra trishifrorë me shifra të ndryshme tek mund të formohen me numrat 0,1,2,3,...,9  
A)504    B)125    C)120    D)60
8. Sa pika formohen me abshisë nga bashkësia {2,3,4,5} dhe ordinatë nga bashkësia {5,6,7,8,9}  
A)45    B) 20    C)16    D)10
9. Sa përkëmbime me tre elemente formohen nga një bashkësi me 6 elemente  
A)120    B)20    C)18    D)16
10. Sa kombinacione me tre elemente formohen nga një bashkësi me 6 elemente  
A)120    B)20    C)18    D)16
11. Në një kuti ndodhen 8 sfera të kuqe. Nxjerrim dy prej tyre. Sa janë rezultatet e mundëshme.  
A)16    B)28    C)56    D)64
12. Dymbëdhjetë vetë do të ndahen në tri grupe. Grupi i parë do të ketë 5 vetë, i dyti 4, ndërsa i treti 3 vetë. Cili numër më poshtë tregon numrin e mundësive për t'u bërë kjo ndarje  
A) $C_{12,5} \cdot C_{7,4}$     B) $C_{12,5} + C_{7,4}$   
C) $C_{12,5} \cdot C_{12,4}$     D) $C_{12,5} + C_{12,4}$
13. Në një bashkësi me 4 elemente sa nënbashkësi me tre elemente formohen  
A)4    B)12    C)24    D)64
14. Sa numra 3-shifrorë formohen me numrat 1,2,3,4,5,6  
A)18    B)27    C)120    D)216
15. Sa targa me katër shifra nuk e kanë zero shifrën e parë  
A)999    B)9000    C)9999    D)100000
16. Sa numra katërshifrorë shumfisha të pesës mund të formohen me shifrat 5,6,7,8 pa i përsëritur këto shifra.  
A)3    B)6    C)12    D)24
17. Në një disko 8 djem dhe 10 vajza duhet të vallzojnë dy e nga dy me njëri-tjetrin. Në sa mënyra mund të formohen çiftet.  
A)40    B)80    C)90    D)160
18. Në etiketa të veqanta janë shënuar shtatë zanoret tona. Pa parë tërheqim njëra pas tjetrës dy etiketa , pa e kthyer etiketën e parë . Sa çifte zanoresh janë të mundshme.  
A)21    B)14    C)42    D)49
19. Sa diagonale ka një 10-këndësh  
A)20    B)35    C)45    D)90
20. Mesatarja e 2,3,x,4,5 është 2. Vlera e x është  
A)-4    B)0    C)1    D)2